

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"UNO Robotics" sh.p.k.**

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**"UNO Robotics" sh.p.k.**

Sot në datën 09/02/2023 bazuar në ligjin Nr. 9901 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe në ligj Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, themeluesit:

Marlin Nano, i biri i Kliti i datëlindjes 25/09/2003, me numër personal të kartës së identitetit K30925070H lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rruga: "Fortuzi, Nd.40, H.1", Tiranë me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Leart Qefalia, i biri i Xhemal i datëlindjes 28/09/2004, me numër personal të kartës së identitetit K40928050J lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr. "Shën Palit", Nd.61,H.1 me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Daniel Bundo, i biri i Fatos- i datëlindjes 14/11/2003, me numër personal të kartës së identitetit K3114040B lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr."Budi", Nd. 031 me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Frajdi Zyla, i biri i Ndriçim - i datëlindjes 01/12/2003, me numër personal të kartës së identitetit K31201051A lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr."Kastriotët", Nd. 168, H.1 me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Redaktuan dhe nënshkruan Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "UNO Robotics" sh.p.k. më poshtë vijon:

**Kreu I**

**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**

**Emri, Data e Themelimit dhe Themeluesit**

1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "UNO Robotics" sh.p.k. (më poshtë e quajtur "Shoqëria") e cila është themeluar më datën 09/02/2023.

1.2 Shoqëria "Uno Robotics" sh.p.k. themelohet nga ortakët Marlin Nano (25%), Leart Qefalia (25%), Frajdi Zyla (25%) dhe Daniel Bundo (25%) me këto të dhëna:

- Marlin Nano, i biri i Kliti- i datëlindjes 25/09/2003, me numër personal të kartës së identitetit K30925070H lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr. "Fortuzi", Nd.40, H.1 me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Leart Qefalia, i biri i Xhemal- i datëlindjes 28/09/2004, me numër personal të kartës së identitetit K40928050J lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr. "Shën Palit", Nd.61,H.1 me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- Daniel Bundo, i biri i Fatos- i datëlindjes 14/11/2003, me numër personal të kartës së identitetit K3114040B lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr."Budi", Nd. 031 me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Frajdi Zyla, i biri i Ndrçim - i datëlindjes 01/12/2003, me numër personal të kartës së identitetit K31201051A lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr."Kastriotët", Nd. 168, H.1 me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

- Adresa Zyrtare e-mail i shoqërisë do të jetë adresa: unoroboticclub@gmail.com
- Numri i Kontaktit të Shoqërisë do të jetë: +355 69 36 72 451

**Neni 2  
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Aktivitet në fushën e robotikës (prodhim dhe ndërtim i robotëve).
- Aktivitet në prodhimin e pjesëve elektronike.
- Ndërtimi i aplikacioneve apo shërbimeve të tjera si p.sh. faqe interneti (website).
- Tregti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm.
- Mirëmbajtje të pajisjeve të ndryshme teknologjike.
- Riparime dhe instalime të sistemeve të ndryshme teknologjike.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pakufizuar.

### **Neni 4**

#### **Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr."Kastriotët", Nd. 168, H.1, Njësia Administrative 11, Tiranë

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyll degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

## **Kreu II**

### **KAPITALI**

#### **Neni 5**

#### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themelues i Shoqërisë është 1000 (një mijë) lekë, e shprehur në katër kuota, të kontribuara nga çdo ortak në vlerën monetare: 250 (dyqind e pesëdhjetë) . Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga të gjithë ortakët e shoqërisë: Marlin Nano 25% (njëzet e pesë përqind), Leart Qefalia 25% (njëzet e pesë përqind), Frajdi Zyla 25% (njëzet e pesë përqind), Daniel Bundo 25% (njëzet e pesë përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht nga:

- Marlin Nano, i biri i Kliti- i datëlindjes 25/09/2003, me numër personal të kartës së identitetit K30925070H lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr. "Fortuzi", Nd.40, H.1.

Leart Qefalia, i biri i Xhemal- i datëlindjes 28/09/2004, me numër personal të kartës së identitetit K40928050J lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr. "Shën Palit", Nd.61,H.1.

Daniel Bundo, i biri i Fatos- i datëlindjes 14/11/2003, me numër personal të kartës së identitetit K3114040B lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr."Budi", Nd. 031.

Frajdi Zyla, i biri i Ndrçim- i datëlindjes 01/12/2003, me numër personal të kartës së identitetit K31201051A lindur në Tiranë, e banues në Tiranë, me adresë Rr."Kastriotët", Nd. 168, H.1.

#### **Neni 6**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anët e kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b. Shit-blerjes;
- c. trashëgimisë;

- d. dhurimit;
- e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8**

##### **Organi Vendimarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. çështjet e tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të

asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

## **Neni 9**

### **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **Neni 10**

### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë përçëshje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin eshpërblimeve;
- e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecucisë se veprimtarisë;
- f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera ndaj administratorëve;
- g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **Neni 12**

### **Përfshirja nga e drejta e votës**

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## **Neni 13**

### **Administrimi**

- a. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje: Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- b. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- c. Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator:  
*Z. Frajdi Zyla, i cili do të ushtrojë kompetencat për një periudhë 5- vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti.*



## Neni 14 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit, të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përshpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente për para asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. kryejnë regjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçëm e me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratori është i detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detytimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartëse 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë; që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera, gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas, neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

1. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

3. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a. U kthen ortakëve kontributet;
- b. U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c. U shpërndan aktivet shoqërisë
- d. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

e. Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Padingësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë-padingë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Neni 16**

##### **Vula**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

#### **Kreu IV**

### **VITI FINANCIAR DHE EKSPERTËT**

#### **Neni 17**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

#### **Neni 18**

##### **Kontrolli Financiar**

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

#### **Neni 19**

##### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të

ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**Neni 20**  
**Bilanci vjetor**

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

**Neni 21**  
**Dividenti**

Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Shoqëria, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

**Kreu V**  
**PRISHJA- RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

**Neni 22**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar;
- e. Me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortaku(ët) merr vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të

shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku(ët).

Nëse Ortaku(ët) nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### **Neni 23**

#### **Riorganizimi i shoqërisë: bashkimi dhe ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakut(ëve), në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### **Neni 24**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 25**

#### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Akt themelimi dhe statuti i shoqërisë u përpilua në katër kopje, për t'jua shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "UNO Robotics" sh.p.k.

## **ORTAKËT E SHOQERISË**

**Marlin Nano**



**Leari Qefalia**



**Frajdi Zyla**



**Daniel Bundo**

